

BASHKIA TEPELENË
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

Në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; VKM Nr.467, datë 31.7.2025 “ Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”; Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.6.2016 “Për rregullat e procedurat e kërkimit, shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullor publik”; Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.2, datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”; si dhe VKM-së Nr. 433 date 08.06.2016 “Për Transferimin në Pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të kullotave Publike” të ndryshuar; VKB nr.38 datë 29.03.2023 “Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullor ndodhur në Bashkinë Tepelenë”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë:

NJOFTIM:

- Fillimin e procedurave të dhënies me qira me anë të konkurrimit të pasurisë së llojit “Kullotë” me numër pasurie 358/3 ZK1565 me sipërfaqe 20.5740 ha, ngastra nr.7 Ekonomia Kullorore Dukaj-Luzat, ndodhur ne fshatin Dukaj, Njësia Administrative Qendër/Bashkia Tepelenë.
- Fillimin e procedurave të dhënies me qira me anë të konkurrimit të pasurisë së llojit “Kullotë” me numër pasurie 58/30 ZK1565 me sipërfaqe 4.6337 ha, ngastra nr.7 Ekonomia Kullorore Dukaj-Luzat, ndodhur ne fshatin Dukaj, Njësia Administrative Qendër/Bashkia Tepelenë.
- Qëllimi i përdorimit do të jetë “për kullotje (dhe qendër stani/stalla, qendër përpunim bulmeti)”, “për ndërtime agroturistike” dhe “për park fotovoltaike”.
- Afati i kontratës së qirasë është deri në 10 vjet.
- Çmimi dyshe me do të jetë në zbatim të VKM Nr.467, datë 31.7.2025 “ Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”, duke filluar për kullotje dhën 200 lekë/krerë, dhi 250 lekë/krerë, gjedh 1000 lekë/krerë në vit; dhe 100 lekë/m²/vit për qendër stani/stalla; 150 lekë/m²/vit për qendër përpunim bulmeti; 65’000 lekë/ha/vit për ndërtime agroturistike; 192’000 lekë/ha/vit për për park fotovoltaike (jo më shumë se 10 ha).
- Vlerësimi i konkurrentëve do të bëhet sipas këtyre pikave:
 - Plani i biznesit dhe investimet 40 pikë
 - Niveli i punësimit 10 pikë
 - Masa e qirasë për ha/vit 50 pikë
- Tërheqja e dokumentacionit të nevojshëm do të bëhet pranë Bashkisë Tepelenë.
- Paraqitja e dokumentacionit do të bëhet në datën 09.04.2026 ora 10:00 në zyrën e protokollit të Bashkisë Tepelenë dhe konkurimi do të vijojë në sallën e mbledhjeve.
- Dokumnetacioni që duhet të plotësohet nga konkurentët për konkurim është:

- a) Kërkesën e operatorit së bashku me gjeneralitetet e tyre.
- b) Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë.
- c) Projektin Teknik të hartuar nga specialist të licencuar ku janë trajtuar të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar (për stallat edhe numri dhe lloji i bagëtive që do mbarështohet dhe certifikate veterinare për gjendjen epizootike për tufën ekzistuese).
- d) Planbiznesi i hollësishëm, ku të përshkruhen qartë:
 - Plani i punësimit, ndikimi i tij në rritjen e të punësuarve,
 - Plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen.
 - Të dhënat për kapacitetet teknike, stafin, makineri që zotëron, etj.
- e) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme.
- f) Ofertën e detyrimit vjetor të qirasë.
- g) Certifikatën e regjistrimit (NIPT) dhe ekstraktin historik të regjistrimit nga QKB të subjektit.
- h) Vërtetimin nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve që subjekti nuk ka detyrime tatimore.
- i) Vërtetimin nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka proces gjyqësor që lidhen me veprimtarinë që ushtron, për subjektin dhe administratorin e subjektit.
- j) Raport i ndikimit në mjedis hartuar nga ekspert i licencuar.
- k) Vërtetim nga nga sektori i tatimeve Bashkia Tepelenë që subjekti nuk ka detyrime.
- l) Garanci të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në planin e biznesit të dorëzuar (vërtetim nga banka).
- m) Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noteruara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për shkualifikim.